

الإسلام دين الفطرة والعقل

والسعادة

**Islami**



## **Islami**

### **fe e natyrshmërisë, arsyes dhe lumturisë**

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

A e ke pyetur veten:

Kush i krijoi qiejt, Tokën dhe krijesat madhështore në to? Kush e krijoi këtë sistem të përpiktë dhe të përsosur që gjendet në to?

Si është i organizuar dhe i qëndrueshëm ky univers madhështor me ligjet e tij, të cilat e rregullojnë atë në mënyrë precize gjatë gjithë këtyre viteve?

A është vetëkrijuar ky univers, ka ardhur prej hiçit apo ka ardhur krejt rastësisht?

### **Po ty kush të krijoi?**

Kush e vendosi këtë sistem të përpiktë në sistemet e trupit tënd dhe në trupat e qenieve të gjalla?

Asnjë njeri nuk do ta pranonte po t'i thuhej: Kjo shtëpi erdhi pa e ndërtuar askush! Ose t'i thuhej: Hiçgjëja është ajo që e krijoi këtë shtëpi! Si mund t'u besojnë disa njerëz atyre që thonë: Ky univers madhështor erdhi pa Krijues? Si mund të pranojë një njeri me mend t'i thuhet: Ky rregull preciz i universit erdhi krejt rastësisht?

Sigurisht që ekziston një Zot madhështor, Krijues dhe Sistemues i këtij universi dhe çdo i gjëje në të: Ai është Allahu i Lartmadhëruar.

Zoti i Lartësuar na çoi të dërguar dhe u zbriti atyre librat hyjnorë, i fundit prej të cilëve është Kurani i madhërishëm, të cilin Allahu ia shpalli Muhamedit, të Dërguarit të fundit të Allahut.

Nëpërmjet librave dhe të dërguarve Ai:

- Na tregoi për Vetën, cilësitë e Tij dhe të drejtën e Tij mbi ne dhe na sqaroi të drejtat tona karshi Tij.

- Na udhëzoi se Ai është Zoti që krijoi njerëzimin dhe se Ai është i Gjallë dhe nuk vdes kurrë. I tërë krijimi është nën grushtin e Tij dhe nën pushtetin e kontrollin e Tij.

- Na tregoi se prej cilësive të tij është dituria, kështu që Ai ka përfshirë çdo gjë me diturinë e Tij dhe se Ai është Gjithëdëgjues e Gjithëshikues, të Cilit nuk i fshihet asgjë, as në Tokë e as në qiell.

Zoti është i Gjalli, i Përjetshmi, Mbajtësi i gjithçkaje, prej të Cilit rrjedh dhe varet jeta e çdo krijese. Allahu i Lartësuar thotë:

(اللَّهُ لَا إِلَهَ إِلَّا هُوَ الْحَيُّ الْقَيُّومُ لَا تَأْخُذُهُ سِنَّةٌ وَلَا نَوْمٌ لَهُ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ مَنْ ذَا الَّذِي يَشْفَعُ عِنْدَهُ إِلَّا بِإِذْنِهِ يَعْلَمُ مَا بَيْنَ أَيْدِيهِمْ وَمَا خَلْفَهُمْ وَلَا يُحِيطُونَ بِشَيْءٍ مِنْ عِلْمِهِ إِلَّا بِمَا شَاءَ وَسِعَ كُرْسِيُّهُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ وَلَا يَئُودُهُ حِفْظُهُمَا وَهُوَ الْعَلِيُّ الْعَظِيمُ)

Allahu! Nuk ka zot që meriton të adhurohet përveç Tij, të Gjallit, të Përjetshmit, Mbajtësit të gjithçkaje. Atë nuk e kap dremitja e as gjumi. Atij i takon gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në Tokë. E kush mund të ndërmjetësojë tek Ai pa lejen e Tij?! Ai e di ç'do të ndodhë në të ardhmen dhe ç'ka ndodhur në të kaluarën, ndërsa ata nuk mund të mësojnë asgjë nga dituria e Tij, përveç aq sa dëshiron Ai. Kursia e Tij përfshin qiejt e Tokën dhe Atij nuk i vjen rëndë ruajtja e tyre. Ai është i Larti, i Madhërishmi. (El Bekare, 255)

- Na tregoi se Ai është Zoti, i Cili përshkruhet me cilësi të përsosura. Ai na dha mendje e shqisa që perceptojnë mrekullitë e krijimit dhe fuqisë së Tij, gjë që na tregojnë madhështinë, fuqinë dhe përsosurinë e Tij. Ai na rrënjosi një natyrshmëri që tregon përsosurinë e Tij dhe se Atij nuk mund t'i vishen mangësitë.

- Ai na tregoi se Zoti është mbi qiejt e Tij dhe nuk hyn brenda botës (është i ndarë nga krijesat e Veta), e as bota nuk është e shkrirë tek Ai.

- Ai na tregoi se duhet t'i dorëzohemi Atij, sepse Ai është Krijuesi ynë dhe Krijuesi e Sistemuesi i universit.

Krijuesi ka cilësi të madhështisë dhe assesi nuk mund të përshkruhet se ka nevojë për diçka ose se ka mangësi. Zoti nuk harron, nuk fle, nuk ha ushqim dhe nuk mund të ketë bashkëshorte e fëmijë. Tekstet që përmbajnë ndonjë gjë që kundërshton madhështinë e Krijuesit nuk janë pjesë e

shpalljes së saktë që është sjellë nga të dërguarit e Allahut (paqja qoftë mbi ta!).

Allahu i Lartësuar në Kuranin e madhëruar thotë:

(قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ \* اللَّهُ الصَّمَدُ \* لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ \* وَلَمْ يَكُنْ لَهُ كُفُوًا أَحَدٌ)

"Thuaj: "Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm!

Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim.

Ai as lind, as është i lindur.

Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Të!" (El Ihlas, 1-4)

Nëse e beson Zotin, Krijuesin... a ke menduar ndonjëherë se cili është qëllimi i krijimit tënd? Çfarë dëshiron Zoti nga ne dhe cili është qëllimi përse ekzistojmë?

### **A mund të ndodhë që Allahu, pasi na krijoi, të na lërë pas dore? A mund të ndodhë që Allahu i krijoi të gjitha këto krijesa pa kurrfarë qëllimi?**

E vërteta është se Zoti, Krijuesi madhështor, Allahu, na tregoi qëllimin përse na krijoi, që është ta adhurojmë vetëm Atë dhe t'i bindemi në atë që dëshiron prej nesh! Ai na tregoi se vetëm Ai është i denjë për adhurim dhe na sqaroi përmes të dërguarve të Tij (paqja qoftë mbi ta!) si ta adhurojmë, si mund t'i afrohem Atij duke i kryer urdhrat e Tij dhe duke i braktisur ndalesat e Tij, si e fitojmë kënaqësinë e Tij, si të ruhem prej dënimit të Tij, si dhe na tregoi vendstrehimin tonë pas vdekjes.

Allahu na tregoi se jeta e kësaj bote është vetëm një provë dhe se jeta e vërtetë dhe e plotë do të jetë në botën tjetër, pas vdekjes.

Ai na tregoi se kush e adhuron Allahun, siç është urdhëruar, dhe largohet nga ajo që Ai e ka ndaluar, do të ketë jetë të këndshme në këtë botë dhe lumturi të përhershme në botën tjetër, e kushdo që e kundërshton Atë dhe mohon, do të ketë mjerim në këtë botë dhe dënim të përjetshëm në botën tjetër.

**Ngase e dimë se nuk mund ta kalojmë këtë jetë pa marrë secili prej nesh shpërblimin për atë që ka bërë, qoftë mirë, qoftë keq. Pra, a nuk do të ketë fare dënim për zullumqarët e as shpërblim për mirëbërësit?!**

Zoti ynë na ka treguar se fitimi i kënaqësisë së Tij dhe shpëtimi nga dënimi i Tij nuk mund të arrihen ndryshe veçse duke hyrë në fenë islame, e cila nënkupton nënshtrimin ndaj Tij dhe adhurimin e Tij, që është i Vetëm e pa ortak, nënshtrimin ndaj Tij me bindje dhe zbatimin e ligjit të Tij me kënaqësi e pranim. Ai po ashtu na ka treguar se nuk pranon nga njerëzit asnjë fe tjetër përveç Islamit. Allahu i Lartësuar thotë:

(وَمَنْ يَتَّبِعْ غَيْرَ الْإِسْلَامِ دِينًا فَلَنْ يُقْبَلَ مِنْهُ وَهُوَ فِي الْآخِرَةِ مِنَ الْخَسِرِينَ)

"Kush kërkon tjetër fe përveç Islamit, nuk do t'i pranohet dhe ai në botën tjetër do të jetë i humbur." (Alu Imran, 85)

Ai që shikon se çfarë adhurojnë shumica e njerëzve sot, do të gjejë se dikush adhuron qenie njerëzore, një tjetër adhuron idhull, një tjetër adhuron planet, e kështu me radhë. Njeriu që është i mençur nuk duhet të adhurojë askënd tjetër, pos Zotit të botëve, i Cili është i përsosur në cilësitë e Tij. Vallë, si mund të adhurojë një krijesë tjetër si veten ose më të ulët sesa veten?! I Adhuruari (Zoti) nuk mund të jetë qenie njerëzore, idhull, pemë ose kafshë!

Asnjëra nga fetë që njerëzit i kanë përqafuar sot, përveç Islamit, nuk pranohet nga Allahu, pasi ato janë fe të krijuara nga njerëzit ose legjislacione që ishin hyjnore dhe më pas janë shtrembëruar nga dora e njeriut. Sa i përket Islamit, ai është feja e Zotit të botëve, e cila nuk ndryshon. Libri i kësaj feje është Kurani i madhërishëm. Ai është i ruajtur ashtu siç e shpalli Allahu dhe ende është në duart e muslimanëve edhe sot e kësaj dite në gjuhën në të cilën iu shpall të Dërguarit të fundit.

Një nga themelet e Islamit është të besosh në të gjithë të dërguarit e Allahut. Të gjithë ata ishin njerëz, të cilët Allahu i fuqizoi me shenja dhe mrekulli, si dhe i dërgoi të thërrasin që të adhurohet vetëm Ai, pa i bërë ortak. Muhamedi صلى الله عليه وسلم është i Dërguari i fundit, të cilin Allahu e dërgoi me ligjin e fundit hyjnor që i shfuqizoi ligjet e të dërguarve para tij, si dhe e fuqizoi me mrekulli madhështore, më e madhja e të cilave është Kurani i madhërishëm, fjala e Zotit të botëve, Libri më i madh që e njohu njerëzimi, i paimitueshëm në përmbajtjen, shprehjen, renditjen dhe vendimet e tij. Në

të është udhëzimi drejt së vërtetës, që shpie drejt lumturisë në këtë botë e në botën tjetër. Ai ka zbritur në gjuhën arabe.

Ka shumë prova racionale dhe shkencore që vërtetojnë pa dyshim se ky Kuran është Fjala e Krijuesit dhe se nuk mund të jetë i krijuar nga njerëzit.

Ndër bazat e Islamit është besimi në melekët dhe besimi në Ditën e Fundit, se Allahu do t'i ringjallë njerëzit nga varret e tyre në Ditën e Kametit për t'i llogaritur për veprat e tyre. Ai që është besimtar, do të ketë lumturi të përjetshme në Xhenet, ndërsa ai që nuk beson dhe bën vepra të këqija, do të ketë dënim të madh në Zjarr. Prej bazave të Islamit është që të besosh në atë që e ka caktuar Allahu, qoftë mirë, qoftë keq.

Feja islame është një program gjithëpërfshirës ndaj jetës, në përputhje me natyrshmërinë e pastër njerëzore dhe arsyen e shëndoshë, rrjedhimisht atë e pranojnë shpirtat e drejtë. Ajo është e përligjuar nga Krijuesi madhështor për krijesat e Tij dhe është fe e mirësisë dhe lumturisë për të gjithë njerëzit në këtë botë dhe në botën tjetër; nuk e dallon një racë nga tjetra e as një ngjyrë mbi tjetrën. Njerëzit në Islam konsiderohen të njëjtë dhe dallimi nga njëri-tjetri bëhet vetëm me vepra të mira.

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿مَنْ عَمِلَ صَالِحًا مِّنْ ذَكَرٍ أَوْ أُنْتَىٰ وَهُوَ مُؤْمِنٌ فَلَنُحْيِيَنَّهٗ حَيٰوةً طَيِّبَةً وَلَنَجْزِيَنَّهُمْ أَجْرَهُم بِأَحْسَنِ مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ﴾

"Cilindo mashkull ose femër që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar, Ne do ta bëjmë që të kalojë jetë të bukur dhe do ta shpërblejmë sipas veprave më të mira, që ka bërë." (En Nahl, 97)

Prej gjërave që Allahu i përmend fuqishëm në Kuranin e madhërishëm është të besohet se Allahu është Zoti dhe i Adhuruari, se Islami është feja (e vërtetë) dhe se Muhamedi është i dërguar dhe se hyrja në Islam është një çështje e domosdoshme, për të cilën njeriu nuk ka zgjidhje. Në Ditën e Kiametit do të ketë llogaridhënie dhe shpërblim. Ai që është besimtar i vërtetë, do të ketë fitore dhe sukses të madh, e ai që është jobesimtar, do të ketë humbje të qartë.

Allahu i Lartësuar thotë:

(... وَمَنْ يُطِيعِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ يُدْخِلْهُ جَنَّاتٍ تَجْرِي مِنْ تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا ذَلِكَ الْفَوْزُ الْعَظِيمُ، وَمَنْ يَعْصِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ وَيَتَعَدَّ حُدُودَهُ يُدْخِلْهُ نَارًا خَالِدًا فِيهَا وَلَهُ عَذَابٌ مُهِينٌ)

"Atë që i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, Ai e shpie në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj, ku do të qëndrojë përherë. Kjo është fitorja e madhe.

Ndërsa atë që nuk i bindet Allahut e të Dërguarit të Tij dhe shkel kufijtë e vënë prej Tij, Allahu e shpie në Zjarr, ku do të qëndrojë përherë dhe për të ka ndëshkim poshtërues." (En Nisa, 13-14)

Ai që dëshiron të hyjë në Islam, duhet të thotë: "Dëshmoj se nuk ka zot që meriton të adhurohet përveç Allahut dhe dëshmoj se Muhamedi është i Dërguari i Tij", duke e ditur kuptimin e saj, duke besuar në të dhe kështu bëhet musliman. Pastaj ai e mëson pak nga pak pjesën tjetër të obligimeve të Islamit, që t'i jetësojë urdhrat e Allahut.

Për më shumë informacione: <https://byenah.com/sq>





## Index

Islami	3
fe e natyrshmërisë, arsyes dhe lumturisë	3
Po ty kush të krijoi?	3
A mund të ndodhë që Allahu, pasi na krijoi, të na lërë pas dore? A mund të ndodhë që Allahu i krijoi të gjitha këto krijesa pa kurrfarë qëllimi?	5
Ngase e dimë se nuk mund ta kalojmë këtë jetë pa marrë secili prej nesh shpërblimin për atë që ka bërë, qoftë mirë, qoftë keq. Pra, a nuk do të ketë fare dënim për zullumqarët e as shpërblim për mirëbërësit?!	5